



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-052

Prishtinë, më 10 shkurt 2009, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e re

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 10 SHKURT 2009

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Naim Maloku, Xhezair Murati dhe Sllobodan Petroviq, ndërsa munguan Nexhat Daci dhe Ibrahim Gashi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri dhe Shefqet Rexhepi;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skender Reçica;

Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 shkurt 2009

2. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave:

- 2.1 Propozim Kalendari i punës së organeve të Kuvendit,
- 2.2 Njoftimi me Planet e punës së komisioneve parlamentare dhe veprimet e mëtejme në hartimin e Programit të punës së Kuvendit,
- 2.3 Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e Agjencisë së Privatizimit për vitin 2008,
- 2.4 Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Myzejene Selmani për lejimin e udhëtimit zyrtar në Dubai.
- 2.5 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Punues të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media për lejimin e udhëtimit zyrtar në Ohër.

3. Te ndryshme

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 shkurt 2009

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 shkurt 2009, u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

2.1 Propozim Kalendari i punës së organeve të Kuvendit,

Kryesia, pasi shqyrtoi Propozim Kalendarin dhe orarin e punimeve të organeve të Kuvendit, vendosi:

Në bazë të Rregullës 6 pika 2, të Rregullës 22 pika 1- 4 dhe Rregullës 43 pika 1 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 shkurt 2009, shqyrtoi Propozim Kalendarin e punimeve të organeve të Kuvendit për vitin 2009, dhe mori këtë

V e n d i m

Miratohet Kalendari i punës së organeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2009, sipas orarit në vijim:

1. Kryesia e Kuvendit /çdo të marte/
2. Kryesia / Shefat e GP / e marta e parë dhe e tretë/
3. Komisionet parlamentare /e hënë, e martë, e mërkurë/
4. Seanca plenare /e ënjta dhe e premtja e dytë dhe e katërt/
5. Kryetari / Komisionet / e ënjta e parë/

2.2 Njoftimi me Planet e punës së komisioneve parlamentare dhe veprimet e mëtejme ne hartimin e Programit të Punës së Kuvendit,

Kryesia u informua se nëntë (9) komisione parlamentare i kanë dorëzuar planet e punës për vitin 2009, ndërsa katër (4) komisione parlamentare pritet t'i dorëzojnë, sot më 10 shkurt 2009.

Kryesia ngarkoi Sekretarinë e Kuvendit që mbi bazën e planeve të punës së komisioneve dhe të Agjendës legjislative të Qeverisë, në afatin më të shkurtër të mundshëm të përgatit Propozim Programin e Punës së Kuvendit, i cili duhet të miratohet në seancë plenare, e cila do të mbahet me 26 shkurt 2009.

2.3 Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e Agjencisë së Privatizimit për vitin 2008,

Kryesia shqyrtoi Informatën e Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me Raportin tremujor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe vendosi që Informata t'u shpërndahet deputetëve, për informim.

2.3 Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Myzejene Selmani për lejimin e udhëtimit zyrtar në Dubai

Kryesia nuk miratoi kërkesën e deputetes Myzejene Selmani për lejimin e udhëtimit zyrtar Në Dubai, prej 30 marsit deri më 1 prill 2009, me arsytim se Kuvendi nuk ka mjete për pagesë të participimit për pjesëmarrje ne këtë konferencë.

2.4 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit punues të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media për lejimin e udhëtimit zyrtar në Ohër

Pas shqyrtimit, Kryesia mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Grupit punues të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media për pjesëmarrje në një punëtori jashtë vendit, prej 13-15 shkurt 2009, në Ohër, në mbështetje të IREX-it, USAID-it dhe të Komisionit të Pavarur për Media, për të amendamentuar Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim.
2. Përbërja e pjesëmarrësve caktohet sipas kërkesës së Grupit punues të Komisionit.
3. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i bartë organizatori, ndërsa Kuvendi do t'i bartë kompensimin e mëditjeve shtesë.

3. Te ndryshme:

- 3.1 Anëtari i Kryesisë së Kuvendit , zoti Slobodan Petroviq, informoi Kryesinë lidhur me vizitën zyrtare të tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12,00.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale